



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Rektori: Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi

Ref. nr. 01/953 dt. 31/07 /2018

Rektori i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi, bazuar në nenin 32 dhe 33 të Ligjit të Punës nr. 03-L-212 , nenit 39 të Ligjit mbi Shërbyesit Civil nr. 03-L-149 si dhe nenit 28 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit, bie këtë:

VENDIM


- I. Nga data 01 gusht 2018 deri më 31 gusht 2018 të gjithë punonjësit e UKZ e shfrytëzojnë pushimin vjetor, të paraparë me ligj.
- II. Në këtë periudhë kohore të gjitha aktivitetet e menaxhmentit të UKZ-së , stafit akademik dhe stafit administrativ të cilat janë në proces, pushojnë së vepruari dhe vazhdojnë nga data 1 shtator 2018.
- III. Përjashtim nga ky vendim kanë vetëm zyrtarët financiarë, të cilët kanë obligim ta ndërpresin pushimin për shkak të obligimeve financiare të universitetit. Agjenda e pushimit të zyrtarëve financiarë bëhet nën mbikëqyrjen e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Menaxherit të Personelit.

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe i njëjti do të shpallet në ueb faqen zyrtare të universitetit

Vendim t'i dorëzohet:

- Sekretarit të Përgjithshëm të UKZ-së
- Dekanëve të njësive akademike
- Menaxherit të Personelit
- Arkivit



Rektori

Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi